

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7998
E shtunë, 22 shkurt 2025
Çmimi 0.50

Nga zgjedhjet në
zgjedhje, ja pse? | FAQE 5



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUR DO TË MUND TË FORMOHET QEVERIA E RE E KOSOVËS? | FAQE 4-5



Me siguri secili prej jush e keni një ide se kush do ta formojë qeverinë e ardhshme të Kosovës, ndonjëse situata këtë herë është


goxha e paqartë. Por, a e dini para cilave afate ligjore gjendet Kosova? Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës ka

theksuar se asnjëra prej partive nuk po duket që ka as ndonjë nguti, as ndonjë interes për formimin e institucioneve

SHEFI I NATO-S: STABILITETI NË KOSOVË, NË INTERES TË TË GJITHËVE NË ALEANCË F.3



MBYLLEN KATËR QENDRA SERBE PËR PUNË SOCIALE NË VERI, DYSHOHET SE 'SHKELËN VULLNETIN E VOTUESVE' F.7



AKTUALE



'VËSHITËRE PA TË': BE-ja SHPRESON NË AKTIVIZIMIN E UDHËHEQJES GJERMANE PAS ZGJEDHJEVE F.2

GJYKATA SPECIALE LIRON ME KUSHT SABIT JANUZIN DHE ISMET BAHTIJARIN F.3

REKTORI HAJRULLAHU TREGON DY PARIMET DREJTUESE NË UP: LIGJSHMËRI DHE MERITOKRACI F.7

EKONOMI



RCC-ja THOTË SE FOKUS I SAJ MBETET KRIJIMI I MUNDËSIVE MË TË MËDHA EKONOMIKE F.8

UP-ja KONTRIBUON PËR SHTETIN DHE MIRËQENIEN E QYTETARËVE, UA SHPËRNDANË CERTIFIKATAT AUDITORËVE TË ENERGJISË F.8

SPORT



KOSOVA E NIS ME FITORE BINDËSE EDICIONIN E RI NË LIGËN E KOMBEVE F.10

RENOVA
PUTZ
Macedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

“Vështirë pa të”: BE-ja shpreson në aktivizimin e udhëheqjes gjermane pas zgjedhjeve

BERLIN, 21 SHKURT - Gjermanët do t'u drejtohen kutive të votimit të dielën, në procesin zgjedhor që mezi është pritur nga Brukseli, pasi shumë zyrtarë shpresojnë që Berlioni do të kthehet shpejt në rolin e tij kyç në politikën e Bashkimit Evropian, teksa blloku evropian përballet me një sërë krizash. Veçse në hall me shkallën e rritjes ekonomike dhe rritjen e konkurrencës, BE-ja është goditur nga kërcënimet e presidentit amerikan Donald Trump për luftë tregtare, apo nga injorimi i liderëve evropianë në tentimet për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë. “Ndonjëherë frikësohemi nga udhëheqja gjermane, mirëpo

është e vështirë të jetojmë pa të”, ka thënë një diplomat evropian për agjencinë e lajmeve AFP. Paqartësitë në Gjermani kanë qenë vetëm vazhdimësi e trazirave politike në Francë, ku presidenti Emmanuel Macron ka emëruar në dhjetor kryeministrin e katërt brenda një viti. Makina franko-gjermane, që konsiderohet më meritorja për përparimin e BE-së, “nuk ka mundur të punojë” dhe të marrë “vendime të mëdha” në një periudhë “kur është më e domosdoshme sesa kurrë më parë”, ka thënë Yann Wernert, analist në Institutin “Jacques Delors”. “Nuk jemi duke parë



shumë përkushtim gjerman në legjislaturën aktuale të BE-së”, ka thënë një diplomat tjetër. Zbrazëtia duket se është mbushur nga të tjerët.

Kryeministri polak Donald Tusk, vendi i të cilit është në krye të Presidencës së BE-së, i ka bërë thirrje Brukselit të bëjë më shumë për t'u përballur me

Rusinë, ndërsa kryeministrja italiane, Giorgia Meloni, është marrë me çështje të migrimit. Megjithatë, analistët vlerësojnë se mungesa ka qenë e dukshme. “A mund të veprojë BE-ja pa Gjermaninë dhe Francën? Në ndonjë rast urgjence do të ishte e mundur, por është më mirë të veprojë me Francën dhe Gjermaninë”, ka thënë një diplomat tjetër. Gjermania do t'i mbajë zgjedhjet e parakohshme më 23 shkurt, pas prishjes së koalicionit trepartiak të kancelarit, Olaf Scholz. Aleanca konservatore CDU/CSU, me kandidatin Friedrich Merz, është duke udhëhequr në sondazhe.

BE-ja do t'i pezullojë sanksionet ndaj Sirisë

BRUKSEL, 21 SHKURT - Bashkimi Evropian do t'i pezullojë javën e ardhshme sanksionet ndaj sistemit bankar të Sirisë, sektorëve të energjisë dhe transportit, thanë diplomatët. Ky vendim po bëhet për të ndihmuar në rindërtimin e shtetit pas rrëzimit nga pushteti të Bashar al-Assadit. Sundimtarët e rinj të Sirisë kanë kërkuar që Perëndimi t'i lehtësojë sanksionet ndaj shtetit



që u vendosën për ta shënjestruar regjimin e Assadit gjatë luftës civile siriane. Por,

Evropa dhe fuqitë e tjera kanë hezituar të bëjnë lëvizje në këtë drejtim pa marrë sinjale të qarta nga sundimtarët e rinj islamistë në Damask nëse ata janë seriozë që të bëjnë një tranzicion gjithëpërfshirës. Hapi që pritet ta marrë dritën e gjelbër gjatë takimit të ministrave të Jashtëm të BE-së në Bruksel është lëvizje formale, pasi muajin e kaluar blloku u pajtua që t'i pezullojë sanksionet

në fusha kyçe. Diplomatët thanë më 21 shkurt se sanksionet mund të rivendosen nëse sundimtarët e rinj të Sirisë shkelin premtimet për t'i respektuar të drejtat e minoriteteve dhe bëjnë kthim prapa në demokraci. Kombet e Bashkuara thanë një ditë më parë se me ritmet aktuale të rritjes, Sirisë do t'i duhen më shumë se 50 vjet që të kthehet në nivelin ekonomik që

kishte para se të niste lufta civile. Shumica e infrastrukturës së Sirisë është shkatërruar dhe ekonomia është shkatërruar për shkak të viteve të izolimit ndërkombëtar, pas shtypjes që i bëri Assadi më 2011 opozitës, gjë që nxiti luftën civile. BE-ja dhe fuqitë e tjera ndërkombëtare po përipiqen të kenë ndikim në Siri pas rrëzimit të Assadit, i cili ishte mbështetur nga Rusia dhe Irani.

Rubio: Takimi Trump - Putin varet nga përparimi në dhënien fund të luftës

UASHINGTON, 21 SHKURT - Një takim eventual mes presidentit amerikan Donald Trump dhe presidentit rus Vladimir Putin do të varet prej përparimit që bëhet drejt përfundimit të luftës në Ukrainë, ka thënë sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio. Ai ka treguar në një intervistë se ia ka bërë me dije ministrin të Jashtëm rus, Sergei Lavrov, në takimin e tyre në Arabinë Saudite më 18 shkurt, se nuk do të ketë takim “derisa të dimë qartë se për çfarë do të mbahet ai”. Takime të tilla nuk mbahen



derisa “të dihet ndonjë rezultat, apo të dihet se është arritur përparim”, ka shtuar Rubio. Në bisedimet në Riad, Shtetet e Bashkuara dhe Rusia janë

pajtuar për të krijuar ekupe negociatore për t'i hapur rrugë përfundimit të luftës, që është nisur nga Rusia në shkurt të vitit 2022. Si Trumpi ashtu edhe Putini kanë thënë se do të dëshironin të mbanin një samit. “Prandaj e them se mbajtja e takimit do të varet nga arritja e ndonjë përparimi për dhënien fund të luftës në Ukrainë, dhe nëse arrijmë që ai takim ta vulosë marrëveshjen, secili duhet ta përgëzojë presidentin Trump për aftësinë e negociimit për paqe”, ka thënë ai.

Rubio i ka bërë këto deklarata teksa ka folur me gazetaren amerikane Catherine Herridge në platformën “X”. Trumpi është duke bërë përpjekje t'i japë fund luftës, ndonëse taktikat e tij kanë alarmuar qeveritë evropiane dhe atë ukrainase, meqë ato shqetësohen se Rusia dhe ShBA-ja mund të pajtohen për një marrëveshje që anashkalon interesat e tyre të sigurisë. Më 19 shkurt Trumpi e ka tronditur Ukrainën dhe aleatët evropianë kur e ka quajtur presidentin Volodymyr

Zelensky “diktator” dhe e ka fajësuar gabimisht Ukrainën për nisjen e luftës. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus, Vladimir Putin, e quan luftën “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Macroni: Do t'i them Trumpit të mos shfaqë dobësi karshi Putinit

PARIS, 21 SHKURT - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha se do të udhëtojë për në Uashington për të tentuar që ta bindë presidentin amerikan Donald Trump se interesat e tij janë në linjë me aleatët evropianë dhe se shfaqja e ndonjë dobësie karshi Vladimir Putinit do ta bënte më të vështirë që të merrej me Kinën dhe Iranin. “Trumpin e njoh. E respektoj dhe besoj se

ai më respekton mua”, tha Macron. “Do t'i them atij: thellë, thellë, nuk mund të tregosh dobësi përballë presidentit Vladimir Putin. Kështu nuk jeni ju dhe kjo nuk është në interesin tuaj”, shtoi Macroni gjatë përgjigjeve në pyetjet që iu parashtruan në mediet sociale. Macroni tha se pasiguria për mënyrën si Trumpi po e

trajton pushtimin trevjeçar rus të Ukrainës është shqetësuese për aleatët e ShBA-së, sepse ai mund të negociojë diçka që është e pamjaftueshme, por kjo, gjithashtu, po krijon pasiguri për Putinin dhe është diçka që duhet të përdoret për të ndihmuar në negociatë. “Fjala është pasiguria. Donald Trumpi krijon pasiguri te të tjerët sepse ai do të bëjë marrëveshje, kështu që

Donald Trumpi, duke krijuar pasiguri për Vladimir Putinin, është një gjë e mirë”, tha Macroni, duke shtuar se presidenti rus nuk e di se çfarë do të bëjë Trumpi dhe si mund të reagojë. Macroni pritet që të hënën të qëndrojë në Uashington dhe do të zhvillojë bisedime me Trumpin, ndërkaq evropianët po synojnë të kenë një rol kyç në negociatat për përfundimin



e luftës në Ukrainë dhe po bisedojnë se si të ofrojnë garanci të sigurisë për Kievin nëse do të arrihet një armëpushim.

SHEFI I NATO-s: STABILITETI NË KOSOVË, NË INTERES TË TË GJITHËVE NË ALEANCË

PRISHTINË, 21 SHKURT - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se stabiliteti në Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë dhe në Serbi është në interes të të gjithëve dhe nuk shihet arsye të besojë që mund të ketë ndonjë ndryshim dramatik sa i përket përkushtimit amerikan në aleancën ushtarake perëndimore.

Ai këto komente i bëri gjatë qëndrimit në Bratislavë të Sllovakisë, kur u pyet në një debat me studentë se a e shihet mundësinë e rifillimit të konfliktit në Kosovë, pasi ka pasur thashetheme se politika e re amerikane mund të çojë deri te largimi i tyre ushtarak. "Më lejoni të jem krejtësisht i qartë, nga ajo çfarë unë po kuptoj nga sistemi amerikan, është se ata janë plotësisht të përkushtuar ndaj NATO-s dhe angazhimeve aktuale. Por, le të shohim se çfarë do të ndodhë. Ne gjithmonë mund të kemi ndryshime të politikave apo adaptime të vogla që mund të ndodhin. Sllovakët, holandezët dhe të tjerët po e bëjnë këtë, por nuk kam arsye të besoj se do të ketë vendime dramatike. Dhe në përgjithësi në Ballkanin Perëndimor duhet të jemi të sigurt që ne të mbajmë në fokus këtë rajon sepse stabiliteti në Kosovë, stabiliteti në Bosnjë dhe stabiliteti në Serbi është në interesin e të gjithëve", u përgjigj Rutte. Kjo deklaratë e shefit të NATO-s vjen në kohën e raporteve të tensionuara në mes të Evropës dhe ShBA-së, pas hapave të ndërmarrë nga administrata amerikane me Rusinë për

përfundimin e luftës në Ukrainë.

Kievi zyrtar ka refuzuar çdo marrëveshje që mund të arrihet midis dy palëve pa praninë e tij në tryezën e negociatave. Në BE është ngritur çështja e mundësisë së dërgimit të forcave paqeruajtëse evropiane në Ukrainë, gjë që presidenti amerikan, Donald Trump, ka thënë se do ta mbështesë, por jo edhe dërgimin e trupave amerikane. "Bild"-i gjerman shkroi më 19 janar se disa shtete evropiane janë të shqetësuara se ShBA-ja mund t'i tërheqë plotësisht trupat e saj nga Evropa dhe se "Italia ka filluar të përgatitet për një tërheqje të mundshme të trupave amerikane nga Kosova".

NATO ka mision paqeruajtës në Kosovë që nga përfundimi i luftës. Aktualisht në kuadër të KFOR-it janë mbi 4 600 trupa nga 29 vende të botës që janë të dislokuar në Kosovë. Numri më i madh i tyre është nga Italia, pasuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Hungaria dhe Turqia.

NATO-ja e shtoi praninë e saj në Kosovë gjatë vitit 2023, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe.

KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX. Ky mision, veç të tjerash, është përgjegjës për sigurinë e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Gjatë ngjarjes në Sllovaki, Rutte foli edhe për kujdesin që



NATO-ja ka për situatën në Bosnjë-Hercegovinë. "Sigurisht, ne dimë se ka disa çështje që duhet të jemi shumë të kujdesshëm në Bosnjë si dhe në marrëdhëniet

në rajon. Pra, hap pas hapi, ne me të vërtetë po përpiqemi ta ruajmë stabilitetin dhe është e rëndësishme sepse është një rajon që ka një histori të jostabilitetit. Fatmirësisht, ne

tani për shumë vjrt kemi një stabilitet të qëndrueshëm në atë pjesë të Evropës, në Ballkanin Perëndimor, dhe ne duhet ta ruajmë atë", tha Rutte.

Në Sllovaki udhëheqësi i aleancës ushtarake perëndimore foli edhe për zgjedhjet parlamentare në Kosovë që u mbajtën më 9 shkurt. "Kemi pasur rishtazi zgjedhje në Kosovë. Rezultati përfundimtar ende nuk është finalizuar, por është e qartë që partia kryesore e cila aktualisht qeverisë Kosovën mund të ketë nevojë për një koalicion. Le të shohim se si do të zhvillohet kjo. Formimi i koalicioneve është pjesë e procesit normal demokratik", tha shefi i NATO-s.

Sipas rezultateve preliminare, Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit Albin Kurti ka fituar 40.80 për qind të votave, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 22.03 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 17.63 për qind të votave, koalicioni në mes të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Socialdemokrate ka marrë 7.46 për qind të votave, si dhe Lista Serbe 4.61 për qind të votave. Në bazë të këtyre rezultateve, asnjëra parti nuk mund ta formojë qeverinë e re, për të cilën duhen 61 vota në Kuvendin prej 120 ulësesh. Pas përfundimit të procesit të votimit, shefi i NATO-s kishte deklaruar se aleanca do të punojë me këdo që do ta udhëheqë Kosovën.

GJYKATA SPECIALE LIRON ME KUSHT SABIT JANUZIN DHE ISMET BAHTIJARIN

HAGË, 21 SHKURT - Kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, ka marrë vendim për lirimin me kusht të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit më 21 shkurt, duke përmendur që ata kanë plotësuar kriterin për modifikim të dënimit, meqë i kanë vuajtur dy të tretat e dënimit me burgim.

Më 4 shkurt të këtij viti Januzi dhe Bahtijari janë dënuar me nga dy vjet burgim, duke u shpallur fajtorë për pengim të drejtësisë, më konkretisht frikësim të dëshmitarëve. Në dënim u është llogaritur edhe koha e qëndrimit në paraburgim.

Të dy janë arrestuar më 5 tetor 2023.

Gjykata Speciale - institucion që funksionon sipas ligjeve të Kosovës, por selinë e ka në Hagë të Holandës - e ka marrë këtë vendim pas një marrëveshjeje të fajësisë që ka arritur Prokuroria e Specializuar me të akuzuarit. Në vendimin për dënimin e

këtyre dy personave nuk është bërë me dije se për cilët dëshmitarë bëhet fjalë, apo për cilin rast gjyqësor. "Kryetarja konstatoi se, megjithëse veprat penale për të cilat z. Januzi dhe z. Bahtijari u shpallën fajtorë janë padyshim të rënda, duke pasur parasysh pasojat që ka frikësimi i dëshmitarëve për administrimin e drejtësisë, ekzistonin disa faktorë që peshuan në favor të modifikimit të dënimit të tyre", është thënë në komunikatën e lëshuar nga Gjykata Speciale.

Gjykata Speciale është themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Në këtë institucion është duke vazhduar procesi gjyqësor kundër ish-presidentit të



Kosovës, Hashim Thaçi, ish-deputetit Rexhep Selimi dhe dy ish-kryetarëve të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, të cilët akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Më 6 dhjetor të vitit 2024 Thaçi i është konfirmuar edhe një aktakuzë e re për

përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në rastin e parë gjyqësor. Përveç Thaçit, në aktakuzën e dytë janë përfshirë edhe emrat e ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçit, ish-shefit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim

Smakajt, ish-kryetarit të Malishevës, Isni Kilajt, dhe Fadil Fazliut.

Të gjithë janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që rëndojnë mbi ta.

Deri më tani kjo Gjykatë ka shpallur aktgjykime për krime lufte dhe për pengim të administrimit të drejtësisë.



KUR DO TË MUND TË FORMOHET QEVERIA E RE E KOSOVËS?

Me siguri secili prej jush e keni një ide se kush do ta formojë qeverinë e ardhshme të Kosovës, ndonëse situata këtë herë është goxha e paqartë. Por, a e dini para cilave afate ligjore gjendet Kosova? Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës ka theksuar se asnjëra prej partive nuk po duket që ka as ndonjë nguti, as ndonjë interes për formimin e institucioneve

PRISHTINË, 21 SHKURT - Të supozojmë se jemi rreth mesit të muajit mars, kur pritet të përfundojë saga e numërimit dhe e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë. Atëherë nis sfida e re - ajo e formimit të qeverisë. Sipas njohësve të çështjeve politike, situatë më të paparashikueshme sesa kjo aktuale në Kosovë nuk ka pasur prej vitesh. Asnjëra parti nuk ka regjistruar fitore bindëse për ta formuar e vetme qeverinë, ndërsa bashkimi i forcave këtë herë duket proces i ndërlikuar.

Cilat janë procedurat përpara?

Presidentja Vjosa Osmani duhet ta thërrasë mbledhjen konstituive të Kuvendit të Kosovës e cila duhet të mbahet më së largu 30 ditë pas certifikimit të rezultateve zyrtar zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Kjo mbledhje konsiderohet e

mbyllur vetëm pasi të jenë zgjedhur kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit. Në bazë të rezultateve preliminare, kryetari i Kuvendit do t'i takojë Lëvizjes Vetëvendosje (LV), e cila ka fituar më së shumti vota. Por, nëse kjo parti nuk e propozon dikë për kryetar, procesi do të ngrijë në vend. Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës na rikujton që, nëse kjo ndodh, nuk do të ishte hera e parë: "Bazuar në praktikën e vitit 2014, kur procedura e konstituimit të institucioneve kishte zgjatur gjashtë muaj - atëkohë Gjykata Kushtetuese nuk ka përcaktuar afat ligjor, as kushtetues, se brenda çfarë periudhe është i obliguar subjekti fitues i zgjedhjeve që të propozojë një kandidat për kryetar të Kuvendit". Sipas tij, nëse nuk do të ketë aktgjykim tjetër të Kushtetueses, procesi mund të zvarritet deri në vitin e ardhshëm, kur të skadojë mandati i presidentes dhe të mbahen zgjedhjet e

jashtëzakonshme. Më 2014 procesi ishte zhblokuar vetëm kur Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kishte braktisur bllokun e atëhershëm opozitar dhe i ishte bashkuar Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në koalicion qeveritar.

Pse mund të krijojë bllokadë LV-ja?

Partia e kryeministrit aktual, Albin Kurti, mund t'i zvarrisë proceset nëse nuk arrin të formojë koalicion të qëndrueshëm për ta përmbyllur ciklin e formimit të institucioneve. Por, nëse kryetari i Kuvendit zgjidhet, atëherë nisin tiktaket e orës për afatet tjera. Presidentja e vendit obligohet ta nominojë partinë fituese të zgjedhjeve si mandatarë për formimin e qeverisë. Ndonëse as këtu nuk ekziston një afat i saktë, vendimet në fuqi përcaktojnë që procesi duhet të zhvillohet "sa më parë që të jetë e mundur". "Unë pres që sapa presidentja ta nominojë kandidatin që propozohet nga Lëvizja Vetëvendosje, i njëjti do të jetë i obliguar që brenda një afati prej 15 ditësh ta propozojë para Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar", ka sqaruar Cakolli. Kabineti duhet t'i sigurojë votat e 61 deputetëve brenda këtij afati, e nëse kjo nuk ndodh, presidentja është e obliguar që brenda 10 ditëve t'i ftojë në konsultim edhe një

herë partitë politike dhe të vendosë, sipas diskrecionit të saj, për mandatarin e re, nëse ajo ia dëshmon se i ka numrat për ta formuar qeverinë. Edhe mandatarja e ardhshme duhet t'i ketë 15 ditë kohë që t'ia paraqesë Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar. Nëse qeveria nuk formohet as pas 40 ditësh, presidentja duhet të shpallë dekretin për zgjedhjet e reja, që duhet të mbahen dyzet ditë prej shpalljes së vendimit.

Cili është skenari më i mundshëm?

Sipas Cakollit, asnjëra prej partive nuk po duket që ka as ndonjë nguti, as ndonjë interes për formimin e institucioneve: "Në njërin anë, LV-ja duket se do ta ketë tejet të vështirë gjetjen e partnerëve në mesin e partive shqiptare, për shkak se, të paktën, në bazë të rezultateve të deritashme, nuk e ka një partner të tillë dhe vetëm me parti minoritare joserbe nuk mund ta formojë qeverinë. Besoj që do ta ketë tejet të vështirë dhe, si rrjedhojë, do të tentojë që ta bllokojë formimin e institucioneve përmes mosmërimin të kandidatit për kryetar Kuvendi". Partitë opozitare do të mund të kenë sfidë tjetër nëse, supozojmë, se do të kryhet çështja e kryetarit të Kuvendit. "Ato do ta kenë problem çështjen e presidentit - e cila menjëherë do të jetë në

muajin mars dhe prill të vitit të ardhshëm - pasi LV-ja, me 47 deputetë, sa i ka në bazë të projeksioneve të tanishme, mund ta bllokojë sërish zgjedhjen e presidentit dhe të shkaktojë zgjedhje të parakohshme", ka vlerësuar Cakolli. Partitë mund të mos kenë gatishmëri për të lëvizur përpara sepse, sipas Cakollit, bëhet fjalë për sfidën e sigurimit të votave, por edhe kërkesat e faktorit ndërkombëtar që mund të peshojnë ndaj qeverisë së re.

Kush do të mund ta formonte një qeveri më stabile?

Cakolli ka thënë se përvoja nga zgjedhjet e vitit 2021 ka treguar se as edhe një qeveri me 68 deputetë nuk ka qenë e mjaftueshme për kalim të projektligjeve në mënyrë efikase. "Për një skenar më solid nevojitet një koalicion mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe partive shqiptare", ka pohuar ai, duke përmendur si më të mundshëm një bashkim mes LV-së dhe PDK-së, edhe për shkak të votave që duhen për pozitën e presidentit të ardhshëm. Në diskutime partiake e jashtë tyre ekzistojnë edhe plot skenarë, dhe thuhet se po bëhen edhe plot matematika të tjera. Koha do të na tregojë se kush kishte të drejtë.

NGA ZGJEDHJET NË ZGJEDHJE, JA PSE?



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Qeveria e pakicës apo e shumicës:

Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve po qartësohet, kanë mbetur edhe votat me kusht, të personave me nevoja të veçanta dhe të diasporës për t'u kompletuar mozaiku dhe arkitektura institucionale e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës. Çka po flitet kuluareve, prej "burimeve të sigurta" nuk pasqyrojnë gjendjen aktuale e më së paku të ardhmen. Rezultatet e sotme nuk i sigurojnë asnjë parti apo koalicioni shumicën e nevojshme për formimin e qeverisë. Koalicionet e mëdha nuk i konvenojnë askujt. Pse? Albin Kurti, si fitues i zgjedhjeve nuk do që të qeverisë me askënd, ai do që të sundojë në një regjim ku LV-ja është epiqendra që vendosë për çdo gjë kurse "partnerët" janë satelitë që sillen rreth kësaj qendre si, "rreth dardhës së Ahmetit". LDK-ja e ka provuar shpatën e LV-së që e ka çarë në dysh, njëra si LDK-ja e gjunjëzuar, tjetra si Guxo apo mizë kali e aziluar në prapnicën e Albin Kurtit. PDK-ja është kockë e fortë për t'u bluar nga "kasapi" Kurti prandaj as LV-ja nuk e dëshiron. Nëse eventualisht, goftë LDK-ja apo PDK-ja bëhen satelitë në regjimin e Albin Kurtit mund ta kenë një fitore taktike por në planin strategjik do të humbasin shumë duke iu nënshtruar një klonimi kurtian e që do të shndërrohet në fatonpeca, mimozakusara, haxhiqamila, agimabhtira, dimalbasha dhe "vlera" të tjera "kombëtare",

politike dhe morale. Albin Kurti e do qeverinë e pakicës e jo të shumicës. Ja pse? Nëse siguron 61 deri 63 vota, pa zemlakun e Mimoza Kusarit, Kurti e formon një qeveri afatshkurtër, jo deri në prill të vitit 2026 por deri në vjeshtë të vitit 2025 kur mbahen zgjedhjet e rregullta lokale. Po dikush mund të thotë se nuk mund të shkohet në zgjedhje të përgjithshme të parakohshme pa një konsensus me partitë tjera parlamentare. Mundet edhe mirë. Pak para zgjedhjeve lokale, Kurti ose jep dorëheqje ose e provokon një mocion për rrëzim të qeverisë dhe shkohet menjëherë në zgjedhje. Nuk ka asnjë mundësi që të pamundësohen këto akrobacione të Kurtit me të cilat mendon ta arrin qëllimin, "me një të rame, dy të vrame" duke e fituar shumicën absolute të pushtetit lokal dhe në nivel vendi. Ky është projekti kurtian për eliminimin politik të opozitës dhe përligjen e një sistemi njëpartiak të tipit të Mongolisë. Projekti i Kurt Mihalit për dy palë zgjedhje në vjeshtë krijon disa lehtësi për Kurtin e të cilat nuk do t'i gëzonte nëse peshkon LDK-në apo PDK-në, si peshq të mëdhenj. E para, duke vonuar formimin e institucioneve nuk e dërgon Zajebnicën në Gjykatën Kushtetuese. Pastaj nuk detyrohet ta zbatojë "Çernobilin politik" e që është Marrëveshja e Brukselit dhe bishti i Ohrit. Deri në kohën pas zgjedhjeve të vjeshtës do të kursehej nga Grenell,

Trump dhe Mask në ndërkohë që mashtruesi dhe rrenci B.B. (bëhet fjalë për Besnik Bislimin e jo për Brizhit Bardon) do ta vazhdonte palaçllëkun e bisedimeve për normalizim. Deri në atë kohë "qeveria në eksil" do ta ushtronte mandatin duke e bërë punën që e di më së miri, e të bërit asgjë. Pastaj, zhvillimet rreth Ukrainës, Rripit të Gazës, Iranit dhe më vonë edhe Tajvanit fort i konvenojnë Albin Kurtit sepse blenë kohë. Edhe protestat në Serbi janë në këtë funksion. Albin Kurti i dihet kohë dhe ka shumë mundësi të blejë kohë. Nëse nuk siguron 61 vota për formim të qeverisë, betejën bllokuese e bënë në Kuvend, me mashën Dehari, deri në kohën kur atij i përshtatet. Për këtë arsye mendoj se opozita as që duhet të mendojë të formojë qeverinë, edhe nëse i krijohen mundësitë kurse, as në imagjinatën më të shëmtuar nuk duhet të mendojë të bëjë koalicionin me Kurtin sepse ai nuk e pranon bashkëqeverisjen, e do vetëm sundimin dhe nënshtrimin! Nëse do që opozita të këndellet politikisht, një mini këndellje ka ndodhur në zgjedhjet e fundit, menjëherë duhet të punojë intensivisht në terren për zgjedhje lokale. Fare nuk duhet të merret me Kurtin dhe LV-në. Albin Kurti e ka të qartë se në konstelacionin aktual të forcave politike nuk mund të llogarisë në një mandat të plotë prandaj dëshiron që në zgjedhjet eventuale të parakohshme në vjeshtë ta


fitojë një mandat të plotë aq më parë që është në panik se mund të lirohen Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe pastaj do të këndohet një këngë tjetër. Rexhep Selimin e ka të vetin. Këto janë përparësitë në të cilën llogaritë Albin Kurti e që nuk do të thotë se do të jetësohen. Shumë apo kryekëput varet nga opozita.

Qeveria e pakicës: Sipas rezultateve aktuale, LV-ja edhe nëse i fiton 80 për qind të votave të panumëruara, maksimalisht mund t'i fitojë 50 mandate. Nëse diaspora nuk voton si më parë, LV-ja do t'i ketë 48 mandate. Rashiqi ka gjasa minimale ta fitojë një mandat por, ta zëmë nëse edhe e fiton, do të jetë një kontribut fare modest për formimin e qeverisë. Deputetët joserbë i kanë të garantuara 10 mandate sikur, besoj edhe Lista Serbe. Nëse Kurti e përjashton Listën Serbe, do të jetë shkatërruese për Mimoza Kusarin, Dejana Mihalit, Elpis Hoxhën dhe të tjerët. Shumë e dhimbshme do të jetë, traumatike me një fjalë. Fatmir Limaj është një patriot i madh. Çdokush që e njeh apo e ka përcjell aktivitetin e tij politik e ka të qartë se ai kurrë nuk ka qenë i dhënë pas karrierës, posteve apo të mirave materiale. Ka qenë dhe është i përkushtuar vetëm për çështje kombëtare. Është si Hasan Prishtina, çdo gjë që e ka e shet për interesa kombëtare dhe për atdhe, nga Malisheva deri në Ballsh. Për këtë arsye edhe u sakrifiku për ndërtimin e një qeverie të

qëndrueshme (si mund të ketë qeveri të qëndrueshme pa Fatmirin) me Albin Kurtin, kryeministër. Mediat nuk po e kuptojnë gatishmërinë e sakrifikimit të Fatmirit për çështje kombëtare prandaj padrejtësisht po e sulmojnë si argat të Kurtit. Fatmiri nuk i intereson asgjë përveç çështjes kombëtare, ku mund të gjejë patriotë si Kurti, Mihali, Kusari, Disha, të përcjellë nga, së paku 80 për qind e deputetëve. Opozita nuk është deklaruar për këtë rirreshtim të Fatmirit përveç Ramushit. Edhe Zafës. Opozita nuk duhet ta pengojë me asgjë formimin e qeverisë Kurti 3, Fatmiri nëse shkon te Albini do të bëhet xhoker i opozitës, do ta forcojë opozitën, do ta ulë Albinin dhe vet do të shndërrohet në fatonpec. Ramushi nuk ka arsye të zemërohet me Fatmirin, vet ia ka mundësuar këtë. Po të shkente AAK-ja e vetme në zgjedhje, pa asnjë dyshim do t'i kishte së paku 8-10 deputetë. Ramushi i ka nëpërkëmbur votuesit e AAK-së, kuadrot që i dhanë AAK-së mundin dhe përvojën prandaj e fituan Fatmirin. Fatmiri, nëse bashkëdyzohet me Albinin kërkesën kryesore nuk do ta ketë ndonjë post me rëndësi por garantimin e Kurtit se do ia lë duart e lira mbi Malishevën. Nëse Amazona konsiderohet si mushkëri dhe oksigjen i botës, Malisheva është oksigjen politik dhe elektoral për Fatmir Limën. Pa Malishevën, Fatmir Limaj është i mbaruar dhe vdesë politikisht.

KAMERAT KINEZE NË INSTITUCIONE: KU JANË ZËVENDËSUAR E KU JO?

Në Qeverinë e Kosovës dhe në sheshin kryesor të Prishtinës vitet e fundit janë hequr kamerat e kontestueshme të prodhimit kinez, të sanksionuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Disa prej tyre janë zëvendësuar me kamera të tjera, gjithashtu të sanksionuara, por më të pranueshme në aspektin e sigurisë, ndërsa disa me kamera amerikano-kanadeze



PRISHTINË, 21 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka larguar nga objekti i saj shumicën e kamerave të sigurisë të firmës "Dahua", një kompani kineze e sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Në ndërtesën e Qeverisë deri më tani janë zëvendësuar shumica dërrmuese e kamerave të sigurisë, ku përfshihen pikat më kritike të sigurisë të ndërtesës", tha për "Radion Evropa e Lirë", zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu.

"Radio Evropa e Lirë" kishte raportuar në lidhje me praninë e këtyre kamerave në objektin qeveritar në fillim të vitit 2022. Në atë kohë qeveria e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje kishte thënë se do t'i analizojë kontratat nga aspekti i sigurisë, meqë kamerat ishin blerë më herët nga qeverisje të kaluara. Sipas Kryeziut, zëvendësimi i kamerave nisi në fund të vitit 2022. "Në proces të zëvendësimit është edhe pjesa tjetër e mbetur (e kamerave). Po punojmë që kjo të bëhet sa më parë", tha tutje ai.

Sipas Departamentit Amerikan të Tregtisë, "Dahua Technology" dhe "HikVision" gjenden në listën e zezë të ShBA-së qysh nga viti 2019, për shkak të, siç thuhet, ndërldhjes së tyre me shkeljet e të drejtave të njeriut në Kinë, përkatësisht me represionin që ua bënë Pekini ujqurëve myslimanë në provincën Ksinjiang. Përveç sanksioneve tregtare, këto dhe disa kompani të tjera kineze që prodhojnë kamera të sigurisë konsiderohen me rrezik për përdorim nga institucionet në ShBA.

Përkatësisht ato konsiderohen që nuk janë në përputhje me Aktin Autorizues të Mbrojtjes Kombëtare (NDAA) të ShBA-së, i cili përcakton nëse pajisje të

caktuara konsiderohen të rrezikshme për sigurinë kombëtare amerikane.

Sipas asaj që "REL"-i ka parë nga terreni, kamerat e reja të vendosura në objektin e qeverisë janë të firmës kineze "Uniview". Kjo kompani, gjithashtu, u përfshi në listën e sanksioneve të ShBA-së në dhjetor të vitit 2024. Megjithatë, deri më tani kjo kompani dhe produktet e saj nuk llogariten të jenë të ndaluara në bazë të rregullativës NDAA.

Së fundmi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri blerjen e mbi 2 000 kamerave të sigurisë, të parapara ta mbikëqyrin procesin e zgjedhjeve parlamentare që u mbajtën më 9 shkurt. KQZ-ja, po ashtu, u furnizua me kamera të kompanisë "Uniview". Në dosjen e tenderit, KQZ-ja e kishte futur në listën e kritereve edhe atë që kamerat të jenë në përputhje me NDAA-në e ShBA-së.

Deri më tani ky institucion nuk u është përgjigjur pyetjeve të "REL"-it se në çfarë legjislacioni apo rregullore të brendshme është e bazuar kjo kërkesë, si dhe cilat janë shqetësimet e sigurisë për produktet që janë të ndaluara me NDAA.

Pse u sanksionuan kompanitë kineze nga ShBA-ja?

Sanksionet ndaj kompanive kineze të teknologjisë nisën gjatë mandatit të parë të presidentit amerikan Donald Trump dhe vazhduan edhe në administratën që pasoi, të Joe Bidenit. Uashingtoni i ka shënjestruar në veçanti kompanitë kineze të prodhimit të kamerave për shkak të "rolit të tyre në ofrimin e teknologjisë vëzhguese ndaj Partisë Kineze Komuniste", duke e ndihmuar atë në përndjekjen e

minoriteteve myslimane në Kinë si ujqurët.

Reid Standish, korrespondent i "Radios Evropa e Lirë" në Pragë, i cili fokusohet në çështjet globale që lidhen me Kinën, thotë se, sipas vendimeve të ShBA-së, këto kompani dyshohet se kanë projektuar pajisje dhe softuerë të veçantë për vëzhgim të këtyre minoriteteve. "HikVision", për shembull, u kap duke projektuar softuerë për njohjen e fytyrës që mund të identifikojë në mënyrë specifike fytyrat 'ujgure', shpjegon Standish.

"HikVision" dhe "Dahua", ende të pranishme në institucione të tjera

Më 2022 "REL"-i kishte raportuar se kamera të firmave "Dahua" dhe "HikVision" po përdorehin si teknologji vëzhguese edhe në disa institucione të tjera shtetërore. Objekte të vëzhguara nga këto kamera përfshinin Prokurorinë Speciale, Ministrinë e Shëndetësisë dhe atë të Tregtisë. Kamera të firmës "HikVision" ende vazhdojnë të jenë të pranishme në të tri këto objekte. Prokuroria Speciale dhe Ministria e Tregtisë deri më tani nuk u janë përgjigjur kërkesave të "REL"-it për koment në lidhje me këtë çështje.

Ndërkaq, Ministria e Shëndetësisë, në përgjigjen për "Radion Evropa e Lirë", tha se ekziston një bazë ligjore në Kosovë për zbatimin e sanksioneve të ShBA-së, sipas një vendimi qeveritar të vitit 2021. Megjithatë, MSh-ja shtoi se blerja e kamerave për këtë institucion u bë gjatë vitit 2019, "para nxjerrjes së vendimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës".

Nga ky institucion nuk kanë

përmendur nëse do të ndërmarrin ndonjë veprim për zëvendësimin e kamerave ekzistuese. "Po, pas marrjes së këtij vendimi nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar që në çdo thirrje t'i përmbushë kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky vendim", tha MSh-ja.

Kamera të "HikVision" më parë vëzhgonin edhe sheshet kryesore të Prishtinës, ndërsa tani ato janë zëvendësuar me kamera të firmës "Avigilon" në kuadër të "Motorola Solutions". Produktet e kësaj kompanie prodhohen në Kanada dhe ShBA.

Komuna e Prishtinës nuk ka treguar kohën dhe arsyen e zëvendësimit të kamerave.

Në vitin 2022 nga komuna i kishin thënë "REL"-it se kontrata e mëparshme me të cilën ishin blerë kamerat "HikVision" ishte trashëguar nga udhëheqësia paraprake e komunës dhe ishte nënshkruar rreth vitit 2020.

Sa është e sigurt teknologjia kineze e vëzhgimit?

Reid Standish thotë se disa çështje teknike që janë zbuluar te disa prodhues kinezë shpesh janë përmendur si arsye për të mos i përdorur ato në ambiente të ndjeshme. Sipas tij, shqetësimet me sigurinë e kësaj teknologjie lidhen me faktin se "sistemet e mbikëqyrjes mbështeten në një farë mase në pajisjet dhe softuerët e prodhuesit të kamerave". "Kjo çon në dy shqetësime kryesore. E para është se sistemet 'cloud' të përdorura nga disa marka kineze janë treguar të jenë më të cenueshme se të tjerat. E dyta është se të dhënat në Kinë u nënshtrohen ligjeve kineze, të

cilat, sipas këtyre ligjeve, i lejojnë Partisë Komuniste Kineze të ketë qasje dhe t'i përdorë të dhënat si të dojë për arsye të sigurisë kombëtare", thotë Standish. "Nuk ka ende prova që kjo të ketë ndodhur, por ajo përmendet në mënyrë rutinore si një shqetësim", shton ai.

Edhe Agjencia për Informim dhe Privatësi në Kosovë i ka thënë "REL"-it se institucionet kanë obligime për sigurinë e të dhënave personale që përpunohen përmes kamerave të vëzhgimit. "Institucionet duhet të sigurohen që pajisjet të jenë të sigurta dhe ta shmangin përdorimin e produkteve që mund të krijojnë rreziqe për sigurinë e të dhënave personale", kanë thënë nga Agjencia. Megjithatë, kur bëhet fjalë për kamerat e sigurisë, kjo agjenci nuk ka komentuar në lidhje me firmat specifike apo rregullativat e sigurisë së ShBA-së dhe mënyrën si aplikohen ato në Kosovë.

Kompanitë kineze janë furnizueset kryesore të teknologjisë së mbikëqyrjes në botë, pasi kamerat e tyre janë të lira, të lehta për t'u përdorur dhe për t'u instaluar, si dhe ofrojnë performancë të lartë.

Kompanitë si "Hikvision" dhe "Dahua" janë pjesërisht në pronësi të shtetit kinez, ndërsa "Uniview" është kompani private, por ka marrë pjesë në kontrata të qeverisë kineze për t'i mbikëqyruar pakicat në Shinxhiang.

Deri më tani ShBA-ja dhe Britania e Madhe kanë vendosur në listë të zezë disa kompani kineze të teknologjisë. Megjithatë, shumica e vendeve evropiane nuk kanë vendosur ndalime të tilla, por kanë zgjedhur t'i heqin kamerat kineze nga përdorimi në institucione qeveritare apo ushtarake.

MBYLLEN KATËR QENDRA SERBE PËR PUNË SOCIALE NË VERI, DYSHOHET SE 'SHKELËN VULLNETIN E VOTUESVE'

MITROVICË, 21 SHKURT - Policia e Kosovës i ka mbyllur të premtën objektet e qendrës për punë sociale në Mitrovicën e Veriut të cilat funksiononin në kuadër të sistemit paralel serb, për shkak të dyshimit se aty janë kryer "veprime të paligjshme lidhur me procesin zgjedhor".

Policia ka thënë përmes një njoftimi se është duke kontrolluar objektet e kësaj qendre në tri komuna me shumicë serbe në veri - Zubin Potok, Leposaviq dhe Zvečan - pasi ka dyshime për "veprime të kundërligjshme lidhur me procesin zgjedhor".

Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka thënë për Radion Evropa e Lirë se në këtë aksion nuk është arrestuar askush dhe se është duke u zhvilluar një intervistë informative me drejtorin përgjegjës të Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicën Veriore dhe Zvečan. "Dyshohet për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve", ka thënë Elshani.

Policia e Kosovës ka thënë përmes një deklarate se ka kërkuar leje nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë për t'i kontrolluar objektet e qendrave për punë sociale pasi katër punonjës të kësaj qendre në Zubin Potok ishin arrestuar më 8 shkurt për "shkelje të vullnetit të votuesve".



Sipas komunikatës, këta zyrtarë të "institucioneve paralele dhe ilegale" dyshohet se i kanë telefonuar qytetarët dhe i kanë kërcënuar, apo u kanë treguar se si të votojnë, duke i kushtëzuar me pagesën e ndihmës sociale.

Zgjedhjet parlamentare në Kosovë u mbajtën më 9 shkurt dhe, sipas rezultateve preliminare të Komisionit Zgjedhor të Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit aktual, Albin Kurti, fitoi më së shumti vota, ndërsa në mesin e komunitetit serb, Lista Serbe, e mbështetur nga Beogradi, fitoi bindshëm. Më 21 shkurt Lista Serbe ka reaguar ndaj bastisjeve në

qendrat e punës sociale në disa komuna në veri të Kosovës, duke pretenduar se kryeministri Kurti "po i shfrytëzon ditët e fundit për të sulmuar edhe një herë gjithçka serbe". "Lista Serbe e dënon ashpër këtë veprimtari të paligjshme dhe antiserbe të falangës së Kurtit dhe dërgon mesazh se asnjë nga të punësuarit apo shfrytëzuesit e përfitimeve sociale nuk do të mbetet pa të drejtat e veta dhe se sot kryesia e partisë sonë do të takohet me të punësuarit dhe do të ofrojë të gjithë mbështetjen e mundshme", thuhet në komunikatë. Partia më e madhe e serbëve në Kosovë i bëri thirrje

bashkësisë ndërkombëtare që t'i dënojë "lëvizjet në rritje që rrezikojnë në mënyrë drastike jetën e mijëra përfituesve të mirëqenies sociale".

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, ka thënë se punonjësit e këtyre qendrave nuk do të mbeten pa paga, ashtu siç asnjë përfitues i ndihmave sociale nuk do të mbetet pa përfitimet që ua paguan atyre shteti i Serbisë. Ai e ka quajtur aksionin e Policisë së Kosovës si "veprim përshkallëzues" me të cilin, sipas tij, kryeministri Albin Kurti "ka goditur drejtpërdrejt kategoritë më të ndjeshme dhe më të rrezikuara të serbëve" në

Kosovë. "Bëhet fjalë për gati 9 000 përfitues të ndihmës sociale, shtesave për fëmijë, ndihmës së njëhershme, si dhe mbështetjes dhe kujdesit nga persona të tjerë, për të cilët këto pagesa janë jetike", ka thënë Petković përmes një deklarimi me shkrim.

Ai është zotuar se Zyra për Kosovën e Qeverisë së Serbisë do të ofrojë "çdo lloj ndihme ligjore dhe forma të tjera mbështetjeje" për punonjësit e qendrave në fjalë.

Më 18 shkurt ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, ka thënë se Serbia ka ndërhyrë në zgjedhjet në Kosovë, duke kërkuar vota për Listën Serbe.

Edhe Nathalie Loiseau, shefe e misionit të Bashkimit Evropian për monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë, pati thënë më 11 shkurt se Serbia kishte ndërhyrë në zgjedhje përmes trysnisë ndaj votuesve serbë në Kosovë.

Pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë marrin të ardhura të ndryshme nga buxheti i Serbisë, si paga, pensione, ndihmë sociale, shtesa për fëmijë, prindër e të ngjashme. Autoritetet e Kosovës kanë mbyllur shumicën e institucioneve që funksionojnë brenda sistemit serb gjatë vitit të kaluar, me argumentin se puna e tyre është e paligjshme, por Beogradi zyrtar ka vazhduar t'u japë paga.

REKTORI HAJRULLAHU TREGON DY PARIMET DREJTUESE NË UP: LIGJSHMËRI DHE MERITOKRACI

PRISHTINË, 21 SHKURT - Rektori i Universitetit të Prishtinës, Arben Hajrullahu, gjatë një interviste në televizionin publik të Kosovës, RTK, përmendi, tri vija të kuqe që nuk do të shkelën dhe dy parime drejtuese që do të zbatohen gjatë qeverisjes prej tij të universitetit më të vjetër, më të madh e më të suksesshëm të vendit.

Në intervistën e parë televizive që prejse e mori mandatin e të parit të UP-së, gati pesë muaj më parë, rektori Arben Hajrullahu, krahas transparencës dhe llogaridhënies, përmendi dy parime kryesore udhëheqëse gjatë mandatit të tij: ligjshmërinë dhe meritokracinë. Ai tha se do të jetë i pakompromis me plagjiaturën, ngacmimet dhe korrupsionin, duke i konsideruar këto tri dukuri negative, vija të kuqe që nuk do të lejohen të kalojnë.

Duke e krahasuar Universitetin e Prishtinës në kohën e drejtimit prej tij, me një makinë të gatshme për rrugë të gjatë dhe të suksesshme, rektori Hajrullahu tha: "Motori është duke punuar shumë mirë, ka karburant shumë dhe bateritë janë plot. Jemi rrugës që do t'i japë hov zhvillimit të këtyre universitetit ta çojmë përpara".

Tregoi se me Statutin aktual të UP-së, të miratur në verën e vitit të kaluar, do t'i hapen mundësi të reja kthimit e qarkullimit të trurit dhe për herë të parë do të mundësohet edhe titulli profesor kërkimor që do t'i japë hov zhvillimit të shkencës.

Por deklaroi se ai dhe menaxhmenti i UP-së do të qëndrojnë me këmbë në tokë. "Ne nuk e kemi luksin që për asnjë moment, asnjë sekondë të vetëm, të kalojmë në vetëkënaqësi. Nuk do ta bëjmë gabimin që ta krahasojmë

universitetin me situatën e para apo pas '99-s. Ne do ta krahasojmë UP-në me universitetet e rajonit dhe më tej", shpjegoi rektori.

Për rektorin Hajrullahu universiteti nuk do të jetë institucion i qarqeve të mbyllura. "Ai do të hapet për më të mirë, sepse ne nuk kemi çfarë të fshehim, kemi shumëçka për të treguar dhe atë me krenarinë më të madhe", tha ai.

Gjatë intervistës rektori foli edhe për sukseset e studentëve dhe profesorëve të Universitetit të Prishtinës. Për projektin "PulseInsight" - një pajisje të dy studentëve të UP-së, e dizajnuar për t'i parashikuar dhe parandaluar sëmundjet e sistemit kardiovaskular dhe respirator, përmes analizës së frymëmarrjes dhe rrahjeve të zemrës, që hyri në mesin e 40 ideve më inovative të botës, duke qenë në konkurrencë me



110 mijë ide dhe projekte. Gjithashtu shpjegoi edhe suksesin e një profesori e studenti që ndërtuan prototipin e ventilatorit mekanik, një pajisje që pompon oksigjenin në mushkri dhe largon prej tyre dyoksidin e karbonit, ndërsa përdoret te pacientët edhe gjatë ndërhyrjeve kirurgjike. Ai u lidh edhe me kohën në të cilën po jetojmë. Tha se digitalizimi është shpëtimi

për UP-në, teksa informoi se në universitet ka nisur evidentimi i procesit mësor me anë të QR kodit.

Rektori nuk i harroi as dukuritë që nuk duhet t'i përmbajë jeta dhe puna e një universiteti. I inkurajoi të gjithë që të kenë kurajë t'i raportojnë rastet e ndonjë shkelje të mundshme, nëse ato ndodhin, në mënyrë që të kanalizohen dhe zgjidhen në organet përgjegjëse.

Policia parandalon një rast të kontrabandës në Han të Elezit

PRISHTINË, 21 SHKURT - Njësitë patrulluese të Policisë Kufitare nga Stacioni Policor për Mbikëqyrje Kufitare - Hani i Elezit kanë parandaluar një rast të kontrabandës në zonën kufitare në mes të Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Rreth orës 03:20 të mëngjesit të së premtes

njësitë patrulluese kanë arritur të lokalizojnë dhe ndalojnë tri automjete në fshatin Seqishtë, Han i Elezit, me të cilat po kryhej kontrabanda e mallrave. Gjatë kontrollit në këto automjete janë gjetur dhe sekuestruar mallra të ndryshme komerciale, përfshirë veshmbathje,

bizhuteri, aksesorë, mjete pune dhe shumë artikuj të tjerë, të cilët dyshohet se po kontrabandoheshin drejt Maqedonisë së Veriut. Si rezultat i këtij operacioni janë arrestuar tre persona të dyshuar: M. B., 23 vjeç, shtetas i Maqedonisë së Veriut, A. N., 32 vjeç, shtetas i Maqedonisë së Veriut dhe I.

L., 19 vjeç, shtetas i Kosovës. Me urdhër të prokurorit të shtetit të dyshuarit janë ndaluar për 48 orë, ndërsa mallrat e kontrabanduara dhe automjetet janë sekuestruar dhe dërguar në terminalin doganor në Han të Elezit. Policia kufitare ka njoftuar se vazhdon të mbetet e përkushtuar në luftën kundër



kontrabandës dhe krimin të organizuar, duke siguruar një kufi të sigurt dhe të kontrolluar.

RCC-ja thotë se fokusi i saj mbetet krijimi i mundësive më të mëdha ekonomike

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 SHKURT - Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) ka shënuar 17-vjetorin, duke festuar pothuajse dy dhjetëvjeçarë të forcimit të lidhjeve më të ngushta, integritit ekonomik dhe qëndrueshmërisë rajonale në Evropën Juglindore, në një pritje të mbajtur në Sarajevë. Që nga themelimi në takimin e ministrave të jashtëm të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) në Sofje më 27 shkurt 2008, RCC ka qenë në krye të nismave që kanë sjellë përfitime të prekshme për rajonin, duke përfshirë heqjen e tarifave të roamingut në Ballkanin Perëndimor dhe uljen e tyre midis rajonit dhe BE-së, përmirësimin e lëvizshmërisë për sipërmarrjet dhe profesionistët, si dhe forcimin e bashkëpunimit në digitalizim, tranzicionin e gjelbër dhe

sigurinë.

Duke reflektuar mbi rrugëtimin e RCC-së dhe vizionin e tij për të ardhmen, sekretari i përgjithshëm i RCC-s, Amer Kapetanovic, theksoi rolin kyç të organizatës për formësimin e bashkëpunimit rajonal "Shtatëmbëdhjetë vjet më parë, RCC u lansua me një vizion - për ta afruar këtë rajon më shumë, duke e bërë atë më konkurrues, më të ndërlidhur dhe më të qëndrueshëm. Sot ai vizion është një realitet në lëvizje dhe është më i rëndësishëm se kurrë. Nga mundësimi i rritjes së sipërmarrjes përtej kufijve deri te lehtësimi i jetës së përditshme për qytetarët, bashkëpunimi rajonal ka sjellë përparim të vërtetë dhe të matshëm. Por ne nuk do të ndalemi këtu - rajoni ynë po evoluon, bota po ndryshon, dhe RCC mbetet e përkushtuar për të udhëhequr rrugën drejt një Ballkani Perëndimor më të fortë, më konkurrues dhe më të



integruar brenda Evropës Juglindore dhe BE-së, si dhe në arenën globale", ka thënë Kapetanovic. Përgjatë viteve RCC ka luajtur rol kyç në afrimin e ekonomive rajonale me Bashkimin Evropian, duke mbrojtur politika që përputhen me standardet e BE-së dhe duke siguruar që bashkëpunimi rajonal të përkthehet në përfitime të drejtpërdrejta për

njerëzit. Nga Tregu i Përbashkët Rajonal dhe nisma Evropa Juglindore 2030, deri te përpjekjet për tranzicionin e gjelbër dhe digjital, si dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë, RCC vazhdon të shtyjë përpara një agjendë rajonale që është ambicioze dhe gjithëpërfshirëse. Duke parë drejt së ardhmes, fokusi i organizatës mbetet në krijimin e mundësive më të

mëdha ekonomike, mbështetjen e të rinjve dhe inovacionit, si dhe sigurimin që Ballkani Perëndimor të mbetet partner i fortë në arenën evropiane dhe globale. "Puna që po bëjmë sot, së bashku me partnerët tanë, do të ketë ndikim për vitet që vijnë. Ne nuk po punojmë vetëm për të ndërtuar politika - ne po formësojmë një të ardhme ku Ballkani Perëndimor është plotësisht i integruar, konkurrues dhe i përgatitur për sfidat përpara. Bashkëpunimi është çelësi, dhe RCC do të vazhdojë të jetë një forcë shtytëse pas tij", ka shtuar sekretari i përgjithshëm. Për ta shënuar këtë moment të rëndësishëm, RCC organizoi një pritje duke mbledhur përfaqësues të pjesëmarrësve të RCC-së, organizatave partnere dhe shoqërisë civile, trupit diplomatik dhe medias, për të reflektuar mbi arritjet e kaluara dhe hapat e ardhshëm në bashkëpunimin rajonal.

UP-ja kontribuon për shtetin dhe mirëqenien e qytetarëve, ua shpërndanë certifikatat auditorëve të energjisë

PRISHTINË, 21 SHKURT - Në amfiteatrin e Bibliotekës Qendrore Universitare u janë shpërndarë certifikatat 46 auditorëve të energjisë në ndërtesa dhe ndriçim publik, të trajnuar nga Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri e Universitetit të Prishtinës (QEQ). I pranishëm në këtë ngjarje të rëndësishme për Universitetin e Prishtinës dhe Kosovën, rektori Arben Hajrullahu, duke iu drejtuar auditorëve që morën certifikatat, tha se të



certifikuarit për eficiencë të energjisë janë shumë të nevojshëm. Drejtuesi i universitetit u

dëshiroi auditorëve që njohuritë dhe kualifikimin e arritur në Universitetin e Prishtinës ta zbatojnë sa më parë në praktikë

dhe jetën e përditshme. Këta auditorë dhe të tjerë para e pas tyre trajnohen në Qendrën për Energji dhe Qëndrueshmëri të Universitetit të Prishtinës (QEQ) në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë. Zëvendësministri i kësaj ministrie, Getoar Mjeku, tha se Universiteti i Prishtinës është më i vjetër se shteti i Kosovës dhe po e ndihmon shtetin, ndërsa auditorëve të certifikuar ua kujtoi se do të ketë shumë punë që do të kryhen së bashku në të ardhmen.

Edhe drejtoresha e Qendrës për Energji dhe Qëndrueshmëri, Bleranda Xhema-Musa, praninë e saj në ceremoninë e certifikimit të auditorëve të energjisë e cilësoi nder për veten, Universitetin e Prishtinës dhe Kosovën. Certifikatat auditorëve të energjisë ua dha profesori dhe koordinatori i trajnimeve, Bedri Dragusha. Deri tash në Qendrën për Energji dhe Qëndrueshmëri të Universitetit të Prishtinës janë trajnuar afër 300 auditorë.

ZKA dhe Fakulteti Ekonomik ofrojnë mundësi për praktikë profesionale për studentët në fushën e auditimit të jashtëm

PRISHTINË, 21 SHKURT - Thirrja për praktikë profesionale në fushën e auditimit të jashtëm vjen në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit lidhur ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) dhe Fakultetit Ekonomik të

Universitetit të Prishtinës dhe përbën mundësi të shkëlqyer për zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Praktika tremujore iu mundëson atyre të angazhohen në proceset e auditimit të jashtëm në sektorin publik,

duke kontribuar kështu si pjesë e ekipeve audituese dhe aplikuar njohuritë tashmë të fituara përgjatë studimeve. Përmes kësaj iniciative ZKA-ja synon t'i avancojë njohuritë e studentëve në auditimin publik dhe ta theksojë rëndësinë e

auditimit në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës në institucionet publike. Prandaj, ftohen studentët e Fakultetit Ekonomik të aplikojnë për këtë mundësi në uebfaqen e fakultetit.



Një muaj Trump në Shtëpinë e Bardhë, bota e kthyer përmbys

Kundër të gjithëve. Luftëra, energji, tregti, emigracion: presidenti i SHBA-së tashmë ka riformuluar në mënyrën e tij rregullat dhe ekuilibrat globalë

Tridhjetë ditët që ndryshuan Amerikën dhe po ndryshojnë botën. Në muajin e parë të kthimit në Shtëpinë e Bardhë, Donald Trump ka shpallur një ortek masash, nga ndryshimet në skenën ndërkombëtare deri te dhjetëra urdhra ekzekutivë për politikën e brendshme. Ai ka hedhur poshtë çdo tabu mbi negociatat me Rusinë për luftën në Ukrainë. Ka vendosur tarifa tregtare ndaj aleatëve dhe rivalëve. Ka urdhëruar dëbimin masiv të emigrantëve. Ka ndalur tranzicionin drejt energjisë së gjelbër dhe mohuar provat e ndryshimeve klimatike. Ka larguar nga puna mijëra punonjës të administratës publike. Përballë këtyre masave, presidenca e tij është krahasuar nga historianët me Franklin Delano Rooseveltin, por në një formë të përmbysur: Në vend që të ndërtojë institucione të mëdha dhe të qëndrueshme, Trump është shkatërruesi i rregullave dhe marrëveshjeve. Ai ka marrë kontrollin absolut mbi sistemin politik dhe ka treguar se nuk do të ndalet para asgjëje.

Lufta tregtare dhe përplasja me Evropën

Në një sulm të drejtpërdrejtë dhe të paprecedentë, Trump ka eliminuar de facto Volodymyr Zelenskyn si liderin e Ukrainës. Ai ka shpallur tarifa të reja mbi tregtinë, duke u kthyer kundër Evropës. “Do të vendosim tarifa 25% për makinat e prodhuara jashtë vendit, për ilaçet dhe për gjysmëpërçuesit,” ka thënë ai.

Kompanitë kanë kohë deri më 2 prill për t’u përshtatur. Ai gjithashtu ka paralajmëruar se tarifatat do të rriten edhe më shumë gjatë vitit të ardhshëm.

Donald Trump si “i dërguari i Zotit”

Donald Trump është i bindur se ka mbijetuar nga një atentat në Pensilvani, dhe se ka një mision hyjnor për të përmbytur. Në rrjetin e tij Truth Social, ai ka shpallur se ka të drejtën për pushtet ekzekutiv absolut. “Kush shpëton vendin e tij nuk shkel asnjë ligj.” Kjo deklaratë i

atribuohet Napoleonit, por në fakt vjen nga mendimtarë të ekstremit të djathtë amerikan, të cilët mbështesin “teorinë e ekzekutivit të unifikuar”. Në fund, kjo mund të shkojë në Gjykatën e Lartë, e cila është tashmë e dominuar nga një shumicë konservatore, e cila është gjithnjë e më e ndjeshme ndaj pretendimeve të Trumpit.

Sulmet

Presidenti i SHBA ka miratuar mbi 100 urdhra dhe dekrete në më pak se një muaj. Që nga ato më të parëndësishmet, si heqja e ndalimit të qeseve plastike, ka riemërtuar Gjirin e Meksikës si “Gjiri i Amerikës”.

Trump ka kërkuar tërheqjen e akuzave për korrupsion ndaj kryebashkiakut të Nju Jorkut, Eric Adams, jo sepse e konsideron të pafajshëm, por sepse e sheh atë si një aleat për dëbimin e emigrantëve. Presidenti ka filluar ndëshkime politike në masë, duke hetuar prokurorët që kanë ndjekur sulmuesit e Kongresit më 6 janar 2021, dhe ka hequr mbrojtjen e sigurisë për Joe Bidenin dhe për republikanët që nuk i janë besnikë, si Mike Pompeo dhe John Bolton.

Doktrina “America First” dhe nacionalizmi ekonomik

Trump po zbaton një populizëm intervencionist, të bazuar te interesat amerikane. “Amerika vjen para gjithçkaje, përfshirë të drejtat e njeriut dhe ligjin ndërkombëtar.”

Në politikën e jashtme, ka firmosur mbi 20 dekrete dhe ka marrë një sërë pozicionesh të reja dhe radikale: Një marrëveshje për paqen në Ukrainë që favorizon vetëm Putinin. Mbështetje për forcat e ekstremit të djathtë në Gjermani. Propozimin për ta kthyer Gazën në një qendër turistike të stilit amerikan, por pa palestinezët. Shkëputje të pjesshme nga NATO. Tërheqje nga marrëveshjet multilaterale si Pakti i Parisit për Klimën dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Një nga projektet më dramatike të Trumpit është shkatërrimi i “soft power”-it



amerikan, duke kërcënuar me mbylljen e USAID, agjencisë së ndihmës humanitare dhe zhvillimit. USAID ka 9,000 punonjës dhe është një nga mjetet kryesore të ndikimit të SHBA-ve në botë. Por luftërat tregtare të Trumpit janë ato që kanë pasur ndikimin më të madh në botë. Ai ka nisur konflikte ekonomike me Kinën, Kanadanë, Meksikën dhe Evropën. Formula e tarifave reciproke, e cila mund të miratohet deri në fillim të prillit, do të shkatërrojë çdo marrëveshje tregtare multilaterale dhe do të izolojë ekonomikisht SHBA-në.

Imigracioni si emergjencë kombëtare

Imigracioni është prioriteti kryesor i Trumpit, i identifikuar nga e djathta nacionaliste dhe populiste si armiku i brendshëm. Trump e ka shpallur atë “një emergjencë kombëtare”, duke justifikuar bastisjet policore dhe dëbimet masive të emigrantëve të parregullt. Fillimisht, dëbimet filluan me ata që kishin kryer krime, por më pas u zgjeruan edhe te njerëzit që kishin vite që jetonin në SHBA, punonin dhe paguanin taksat, por pa dokumente të rregullta. Deri në fund të janarit, rreth

900 persona dëboheshin çdo ditë, por shifra ra në 600 në mes të shkurtit, duke shkakuar pakënaqësinë e presidentit.

Lufta kundër ndryshimeve klimatike dhe të drejtave civile

Por imigracioni nuk është e vetmja emergjencë kombëtare. Trumpi ka miratuar procedura të posaçme për sektorin e energjisë, për të përshpejtuar prodhimin nga burimet fosile, pa marrë parasysh efektin serë. Ai ka shkatërruar disa të drejta civile që ishin konsideruar të fituara, duke anuluar me shtatë urdhra presidencialë programet federale për diversitetin, barazinë dhe përfshirjen, si dhe ka nisur hetime qeveritare ndaj disa kompanive të mëdha, duke i detyruar ato të tërhiqen nga politikatat e përfshirjes sociale.

Reforma drastike në administratën federale

Trump ka nisur një reformë të gjerë të qeverisë, me mbi 15 urdhra ekzekutivë. Figura qendrore në këtë reformë është Elon Musk, i cili drejton Departamentin e

Efikasitetit (Doge). Musk ka premtuar kursime prej 2 trilionë dollarësh, por për ta arritur këtë ka nisur shkurtimin e 200,000 punonjësve federalë, nga 2.3 milionë të punësuarit aktualë.

Disa nga shkurtimet kanë qenë kaq të shpejta dhe të pakontrolluara, sa që edhe Musk është detyruar të rikthejë disa punonjës urgjentisht, si fjala vjen, ata që menaxhonin armët bërthamore në Departamentin e Energjisë. E djathta e re amerikane, me qasjen e saj radikale, mund të çojë në eliminimin e të gjithë ministrive dhe agjencive, përfshirë Departamentin e Arsimit, Byronë e Mbrojtjes së Konsumatorit (CFPB), e cila mbron qytetarët nga abuzimet financiare.

Çfarë e pret Amerikën dhe botën?

Nëse 30 ditët e para të Trumpit kanë dërguar një mesazh të qartë brenda dhe jashtë Amerikës, 47 muajt e mbetur të mandatit do të tregojnë nëse ai do të jetë vërtet “anti-Roosevelt”. Amerika dhe bota tashmë kanë ndryshuar, por mbetet për t’u parë çfarë gjurmësh do të lërë Trump në demokracinë amerikane dhe në ekuilibrat ndërkombëtarë. / bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova mposhti Azerbajxhanin, të dielën përballet me Zvicrën

Kosova ka triumfuar kundër Azerbajxhanit me rezultat 81:79 (20:21, 23:20, 17:18, 21:20). Në një sfidë dramatike deri në fund, "dardanët" kanë arritur të triumfojnë, duke

shënuar fitore shumë të rëndësishme në parakualifikimet për FIBA Kupën e Botës 2027. Te Kosova u dalluan Mikaile Tmusiq me 21 pikë e katër kërcime dhe

Divine Myles me 16 pikë, pesë kërcime dhe gjashtë asistime. Kosova tani ka dy fitore dhe tri humbje, ndërsa Azerbajxhani një fitore dhe katër humbje. Lidere është Zvicra me pesë

fitore, kurse Irlanda ka dy fitore dhe tri humbje. Kosova të dielën përballet me Zvicrën në ndeshjen vendimtare për ta kërkuar kualifikimin në fazën e ardhshme.



Kosova e nis me fitore bindëse edicionin e ri në Ligën e Kombeve



PRISHTINË, 21 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll për vajza e ka nisur me sukses edicionin e ri në Ligën e Kombeve. Në kuadër të Grupit 6 në Ligën C, "dardanët" triumfuan si mysafire në Shkup ndaj Maqedonisë së Veriut, me rezultat bindës 4:0. Kjo ishte ndeshja e parë e Kosovës nën drejtimin e përzgjedhësit të ri, Sami Sermahaj. Vajzat tona e nisën fuqishëm ndeshjen dhe kaluan në epërsi qysh në

minutën e gjashtë, kur Kaltrina Biqkaj shënoi nga brendësia e zonës. Edhe pas golit Kosova vazhdoi të dominojë dhe krijoi disa raste të mira shënimi, por pjesa e parë u mbyll me epërsinë minimale 1:0. Në pjesën e dytë "dardanët" u shfaqën edhe më superiore. Pas vetëm katër minutash lojë, Kaltrina Biqkaj realizoi golin e dytë personal dhe të ekipit me një gjuajtje nga distanca, duke e çuar rezultatin në 2:0. Epërsia e

Kosovës u thellua më tej, kur Gentiana Fetahaj shënoi në minutën e 65-të dhe vetëm dy minuta më vonë, Valentina Mehaj vulosi rezultatin përfundimtar 4:0. Kjo fitore është një sinjal i fortë për ambiciet e Kosovës në këtë edicion të Ligës së Kombeve për rikthim në Ligën B. Ndeshjen e radhës "dardanët" do ta zhvillojnë më 25 shkurt kundër Letonisë në stadiumin "Fadil Vokrri", duke filluar nga ora 14:00.

SHKURT

Rahoveci fiton derbin, Besa fiton në Mitrovicë

Rahoveci e mposhti Kastriotin e Ferizajt me rezultatin 41:38 në derbin e xhiros së 18. Kastrioti ishte vendas, kurse ndeshja u zhvillua në Lipjan. "Vreshtarët" kanë kontrolluar gjithë ndeshjen, ndërsa kanë mbajtur epërsi bindëse që shkoi deri në nëntë gola. Granit Kadiri i shënoi 10 gola për Rahovecin, ndërsa Jon Muqolli i shënoi tetë. Egzon Gjuka i shtoi gjashtë e Mali Luzha pesë. Lulzim Shabani ishte më efikas te ferizajasit me 11 gola. Tetë i shënoi Deniz Teriziqi, sa i kishte edhe Besnik Bytyqi. Rahoveci ka vetëm fitore këtë edicion, ndërsa udhëheq në tabelë me 36 pikë. Kastrioti është i treti me 24 pikë, ndërsa e ka një ndeshje më pak të zhvilluar. Të enjten u zhvillua edhe ndeshja në mes të Trepçës dhe Besa Famgasit. Fitorja në Mitrovicë i takoi ekipit pejan, Besa Famgas, me rezultat 45:34. Jon Vokshi udhëhoqi Besën me 14 gola, ndërsa Elion Vokshi i kishte nëntë. Te vendësit, Ardi Halili i shënoi dhjetë gola, ndërsa Sali Maxhera tetë. Besa është e dyta me 28 pikë. Trepça renditet e fundit me gjashtë pikë.

Tare, drejtor sportiv i Milanit?

Me eliminimin e hershëm e të turpshëm të Milanit nga Liga e Kampionëve, presioni ka rënë shumë mbi trajnerin Sergio Conceicao, mbi të gjitha ndaj bordit drejtues, me Zlatan Ibrahimoviçin që udhëheq anën sportive. Megjithatë nuk është fajtor kryesor, Ibrahimoviç si këshilltari i lartë i "Redbird" ka zhytur imazhin publik të klubit në figurën e tij dhe sot e gjen veten duke lundruar në ujëra mjaft të trazuar së bashku me trajnerin. Suedezi do t'i durojë goditjet të paktën deri në verën e ardhshme, kur Xherri Kardinale pritet të emërojë një drejtor të pastër sportiv përkrah tij. Emrat e zbuluar për të plotësuar këtë rol janë ata të ish-drejtorit të Juventusit, Fabio Paratici, i cili është ende i pezulluar deri në vjeshtë, por mund të funksionojë fillimisht si konsulent. Një tjetër profil është ai i Andrea Bertas, i cili janarin e kaluar i tha lamtumirë Atletikos së Madridit pas një bashkëpunim mbi 10-vjeçar teksa deri pak javë më parë u përfol edhe Francois Modesto, dikur në bordin drejtues të Monzas. Emri më i fundit, por sigurisht jo për nga koha, është ai i Igli Tares që është përmendur edhe në të kaluarën për një lidhje me klubin kuqezi. Tare ka qenë drejtor sportiv për shumë vjet i Lazios, duke e kryer këtë detyrë me shumë sukses tek ish-ekipi i tij.

Ballkani ndahet baras me Feronikelin '74

Suharekë, 21 shkurt - Ballkani është ndalur në barazim 1-1 në përballje me Feronikelin '74 në ndeshjen e vlefshme për javën e 21-të në Albi Mall Superligën e Kosovës. Therandasit janë ndalur në shtëpi nga drenicasit në ndeshjen e zhvilluar pasditen e së premtes, duke shkuar në dy ndeshje pa fitore. Pjesa e parë e

ndeshjes u karakterizua me lojë thuajse të barabartë nga të dyja skuadrat, por vetëm me mysafirët që gjeten rrugën e rrjetës. Goli i vetëm në këtë pjesë erdhi në minutën e 45-të me anë të Hasan Hysenit, i cili shënoi për epërsinë 0-1. Në pjesën e dytë ishin vendasit që krijuan më shumë raste dhe arritën ta

gjejnë golin e barazimit, por jo më shumë. Goli i vetëm në këtë pjesë erdhi në minutën e 65-të dhe ishte Valery Stepanenko i cili shënoi autogol për 1-1 dhe me këtë rezultat u mbyll ndeshja. Pas këtij barazimi, Ballkani e sheh veten në pozitën e dytë me 37 pikë, ndërsa Feronikeli '74 renditet i fundit me 11 pikë.



Unitedi e Roma 'peshkojnë' Sociedadin dhe Bilbaon

NYON, 21 SHKURT - Në selinë e UEFA-s në Nyon të Zvicrës të premten është hedhur shorti për fazën e 1/8-s në Ligën e Evropës, teksa tashmë dihen edhe kundërshtarët e mundshëm të skuadrave për secilën fazë. Pas Ligës së Kampionëve, radha i erdhi edhe ekipeve të Ligës së

Evropës për t'i mësuar kundërshtarët e tyre për fazën e 1/8-tës. Edhe në garën e dytë elitare evropiane të klubeve do të shohim ndeshje të forta në këtë fazë me skuadrat që do të duan me çdo kusht një vend në çerekfinale. Ndeshja më e fortë në këtë fazë është ajo në mes të Real Sociedadit -

Manchester Unitedit, por interesant do të jetë edhe në takimin Roma - Athletic Bilbao. Në këtë fazë Ajaxi do të ndeshet me Eintracht Frankfurtin, Lazio me Viktoria Plzenin, Tottenham Hotspuri me AZ Alkmaarin dhe Fenerbahçe - Rangers. Dy takimet e tjera të 1/8-s në

Ligën e Evropës janë Bodo/Glimt - Olympiacos dhe FCSSB - Lyon. Çiftet e 1/8-s: Viktoria Plzen-Lazio, Bodo/Glimt-Olympiacos, Ajax-Eintracht Frankfurt, AZ Alkmaar-Tottenham H., Real Sociedad-Manchester U., FCSSB-Lyon, Fenerbahçe-Rangers, Roma-Athletic Bilbao.



Përballje titanësh në Ligën e Kampionëve

NYON, 21 SHKURT - Në selinë e UEFA-s në Nyon të Zvicrës është hedhur shorti për fazën e 1/8-s në Ligën e Kampionëve. Ky short ka filluar me shortin e Ligës së Kampionëve, i cili është planifikuar të bëhet para atij të Ligës së Evropës dhe Ligës së Konferencës. Në raundin e 1/8-s do të luajnë klube si Club Brugge, Bayern Munich, Benfica, Feyenoord, Borussia Dortmund, Paris Saint-Germain, PSV Eindhoven dhe



ÇIFTET E 1/8-TËS NË LIGËN E KAMPIONËVE

Club Brugge - Aston Villa
Borussia Dortmund - Lille
Real Madrid - Atletico Madrid
Bayern Munich - Bayer Leverkusen
PSV Eindhoven - Arsenal
Feyenoord - Inter
Paris Saint-Germain - Liverpool
Benfica - Barcelona

Real Madrid. Këto skuadra iu bashkuan Liverpoolit, Barcelonës, Arsenalit, Interit, Atletico Madridit, Bayer Leverkusenit, Lilles dhe Aston Villës përmes fazës "play-off" të kësaj gare. Ndeshjet më të zjarra të kësaj faze janë ato në mes të Real Madridit - Atletico

Madridit, Bayern Munichut - Bayer Leverkusenit dhe Paris Saint-Germainit - Liverpoolit. Barcelona, Interi dhe Arsenali ishin skuadra më me fat në këtë short. Duetet e para do të luhen më 4 dhe 5 mars, ndërsa ato të kthimit më 11 dhe 12 mars.

Clevelandi vijon të dominojë, LeBroni magjik për lakersat

PORTLAND, 21 SHKURT - NBA është rikthyer në fushë pas pushimit për shkak të "All Star Game". Skuadra e Clevelandit vijon të ketë frenat e renditjes në dorë pas fitores me rezultat 110-97 në fushën e Brooklynit. Donovan Mitchell me 26 pikë ishte më i miri për Cavaliersin. Fitoi edhe skuadra e Milwaukeees, që mundi me rezultat 116-110 Clippersat në një përballje të ekuilibruar. Antetokounmpo me 23 pikë e Lopezi me 22 u dalluan për Bucksin. Fitoi edhe Denveri, 129-115 ndaj Charlottes, ndeshje ku dallimin e bëri



dyshja Jokiç - Murray, që realizuan 63 pikë së bashku. Skuadra kampione e Bostonit fitoi me shifrat 124-104 ndaj Philadelphias, duke qenë në vendin e dytë në Lindje. Pritchard me 28 pikë, që e nisi ndeshjen nga stoli, u kthye në lider për Celticsin. Ekipi i

lakersave arrin një fitore të vështirë ndaj Portlandit jashtë fushës me shifrat 110-102. LeBron Jamesi ishte magjik, duke realizuar 40 pikë. San Antonio mundi me shifrat 120-109 Phoenixin, sfidë ku u dallua Foxi me 26 pikë.

REZULTATET

Indiana - Memphis	127-113
Philadelphia - Boston	104-124
Atlanta - Orlando	108-114
Brooklyn - Cleveland	97-110
New York - Chicago	113-111
Milwaukee - Clippers	116-110
Denver - Charlotte	129-115
San Antonio - Phoenix	120-109
Portland - Lakers	102-110

Zanetti: Synojmë t'i shkojmë deri në fund kampionatit dhe Ligës së Kampionëve

Zëvendës-presidenti i Interit, Javier Zanetti, komentoi shortin e Ligës së Kampionëve që vendosi zikaltrit përballë Feyenoordit. Zanetti vlerësoi kundërshtarin, ndërsa shtoi se Interi nuk bën zgjedhje mes Ligës së Kampionëve apo

kampionatit, por synon t'i shkojë deri në fund të dyja kompeticioneve. "Rrugëtimi ynë në Ligën e Kampionëve ka qenë i shkëlqyer deri tani. Feyenoordi është një skuadër që duhet respektuar. E kemi parë të gjithë se çfarë ka bërë. Ne kemi gjithmonë një

përgjegjësi të madhe. Do të përpiqemi të çojmë një ekip italian sa më lart të jetë e mundur. Kampionati apo Liga e Kampionëve? Nuk mund të bëjmë zgjedhje", ka thënë Zabetti. "Synojmë t'u shkojmë deri në fund të dyja kompeticioneve. E dimë se

çfarë do të thotë të jesh kampion i Italisë dhe duhet të kujtojmë se jemi të fundit që kemi fituar Ligën e Kampionëve. Do të përpiqemi ta nderojmë Italinë dhe të shkojmë në finale si dy vjet më parë. E dimë se është e vështirë, por i duam të dyja.

Ne e dimë se çfarë do të thotë të konkurrosh në Itali dhe Evropë. Me kaq shumë ndeshje nuk është e mundur të jemi gjithmonë në maksimumin tonë, por ne gjithmonë punojmë për të dhënë më të mirën", ka deklaruar Zanetti.

SHKURT

Granit Dervisholli, trajner i ri i Feronikelit '74

Skuadra e Feronikelit '74 ka njoftuar zyrtarisht se drejtimin e skuadrës e ka marrë trajneri Granit Dervisholli. Feronikeli '74 vendosi ta shkarkojë nga detyra trajnerin italian Giovanni Colella pas rezultateve jo të kënaqshme. Megjithatë, nuk ka vonuar shumë dhe klubi nga Drenasi ka njoftuar për pasuesin e tij. "FC Feronikeli 74 ka kënaqësinë të njoftojë se trajneri Granit Dervisholli është emëruar në postin e trajnerit të ekipit të parë. Pas një periudhe të gjatë si trajner dhe ekspert i futbollit, Dervisholli do ta udhëheqë skuadrën drejt objektivave ambicioze dhe synimeve të mëdha në sezonet e ardhshme", thuhet në njoftimin e Feronikelit '74.

Ismajli kthehet në fundjavë kundër Atalantës

Ardian Ismajli ka munguar në dy ndeshjet e fundit të Empolit, kundër Milanit dhe Udineses, takime që skuadra toscane i ka humbur të dyja. Mbrojtësi la fushën e lojës në minutën e 60, në duelin kundër Juventusit më 2 shkurt, për shkak të problemeve muskulore. Ky ishte dëmtimi i parë që Ismajli ka hasur që nga fillimi i sezonit, duke luajtur në total 23 ndeshje në Serinë A, nga 25 që janë zhvilluar gjithsej. Sipas raportimeve nga Italia, të gjithë tek Empoli i kanë sytë nga Ismajli sepse ai është një pikë e rëndësishme në mbrojtje. Siç thuhet, 28-vjeçari mund të jetë në dispozicion të trajnerit këtë fundjavë, ku Empoli do të presë në shtëpi Atalantën e Gjithshitit.

Haaland: Nuk mund të fitojmë gjithmonë

Manchester City e ka mbyllur aventurën në Ligën e Kampionëve. Kampionët në fuqi të Anglisë, të udhëhequr nga Pep Guardiola, u dorëzuan përballë një Kylian Mbappe të jashtëzakonshëm, i cili me tripletën personale i dha fitoren dhe kualifikimin Real Madridit (3-1). City nuk pati shumë mundësi, veçanërisht duke qenë se në "Santiago Bernabeu" u paraqit pa yllin dhe sulmuesin e vet kryesor, Erling Haaland. Trajneri Guardiola shpjegoi në konferencën për shtyp arsyen e mungesës së tij: "E kishte të vështirë të ecte, as të zbriste shkallët, ndaj në mëngjes na tha se nuk ndihej mirë". Norvegjezi, i cili këtë sezon ka shënuar 27 gola (19 në Premierë Ligë dhe 8 në Ligën e Kampionëve), u dëmtua në minutat e fundit të ndeshjes së fundit të kampionatit ndaj Newcastle Unitedit, ku asistoi James McAtee në fitoren 4-0. Pas eliminimit, Haalandi reagoi në rrjetet sociale me një mesazh të qartë: "Qëndrojmë të bashkuar. Ndonjëherë në jetë duhet të kalosh përvoja të tilla dhe të mësosh prej tyre. Nuk mund të fitosh gjithmonë. Së bashku do të ngrihem sërish". Gjendja e Haalandit për ndeshjen e së dielës ndaj Liverpoolit në "Etihad Stadium" (17:30) mbetet e dyshimtë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Arda&Elika” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812160703 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Arda&Elika” D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812160703 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Arda&Elika” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 812160703 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Adresa: rr.Ibrahim Krasniqi Prishtinë lurnshpk@gmail.com Nr tel: 045510011&46 143401&45 690 141

Prishtinë, 13.02.2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 810084062 me adresë: Rr. „Ibrahim Krasniqi“ nr. 10, Komuna e Prishtinës Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.3861-2/23 dt. 23.10.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimi nr. 07-350/02-0032027/23 dt. 10.05.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimi për Kushte Ndërtimore Nr. 07-0350/04-0085583/23 dt. 12.02.2024 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: Nr. 07-351/02-0044941/24 të datës 29.11.2024 për “Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaike me kapacitet prej 483.12 kW, ZK Shajkoc, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Pëlqimin Elektroenergetik Nr. 19358 dt.20.10.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratrat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut. Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund të paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: lurnshpk@gmail.com dhe LEGAL-LECCENSING@ero-ks.org Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ES E Marpessa” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812108018 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ES E Marpessa” D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812108018 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ES E Marpessa” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 812108018 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Adem Arifi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

Redon Albert Koshi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII dhe diplomën e sh.m.l.e “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Rizo Hodaj nga Kabashi KK Prizren shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.a.t. “Abdyl Frashëri” Prishtinë Bukëpjekës.

- Dulë Gjuraj Gerqinë KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-8.

- “Aroni DF” SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin unik identifikues të biznesit 812228824 lëshuar nga ARBK.

Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

